REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorëzuar Primljeno/Predato Recieved/Delivery | 15 . 10 201 8 viti god year | | |
|---|---|---|---|
| Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No: | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Količina Quantity |
| SKPMSHCK | 6005/2018 | | 113 |

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova – Republic of Kosovo

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
### NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
### INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

**A.nr. 619/2018**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Gjylinaze Gola dhe Lulzim Aliaj-anëtar, dhe Ardita Perçuku-Shyti- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses për shqyrtimin e ankesës A. Nr.619/2018, të datës 02.10.2018, të ankuesit Arben Qollaku, me adresë rr."Shukrije Obërtinca", Objekti 19, Hyrja 1 Nr.41-Fushë Kosovë,, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme, në çështjen juridike " çështje e avancimit në karrierë", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin , si dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.10.2018 mori këtë:

## V E N D I M

**I.** **Detyrohet** Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme që të bëjë shqyrtimin e ankesës të datës 24.08.2018, të parashtruar nga ankuesi Arben Qollaku, brenda aftit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

**II.** **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën **I** të tij.

**III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi Arben Qollaku, i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme , sipas Akt emërimit të datës 19.10.2012 në pozitën "Zyrtar i Larte për te Drejtat e Njeriut", në Departamentin për Çështje Ligjore, Traktate dhe te Drejtat e Njeriut, është transferuar ne pozitën "Zyrtar i Larte për Seksionin e Afrikave", ne Departamentin për Marrëdhënie Dypalëshe.

Ministri i Ministrisë se Punëve të Jashtme, me datën 13.09.2016, ,ka nxjerr vendimin me numër Nr.377/2016, me te cilin ankuesi është caktuar të shërbej në Misionin Diplomatik të Republikës së Kosovës ne Frankfurt/Gjermani me gradën Diplomatike Sekretar i Tretë.

Po ashtu me datën 24.07.2018, sipas rekomandimit te Komisionit për Grada dhe Disipline Ministri i Ministrisë se Punëve te Jashtme, nxjerre vendim me numër Nr.675/2018, me te cilin ankuesit i jepet grada diplomatike Sekretar i Dytë

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit për Grada dhe Disipline, me datën 24.08.2018, me numër të protokollit Nr.2178, ka parashtruar ankesë ne Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, tek Ministria e Punëve të Jashtme.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datën 14.09.2018, përmes e-mailit zyrtar e ka njoftuar ankuesin se në bazë të vendimit Nr.ZSP-46/2018 te datës 16.04.2018, nuk janë kompetent për shqyrtimin e ankesës dhe e kanë rekomanduar që ti drejtohet Komisionit për Grada dhe Disiplinë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme, nuk e ka shqyrtuar ankesën e ankuesit edhe për kundër obligimit ligjor.

Ankuesi, Arben Qollaku, i pakënaqur me mos shqyrtimin e ankesës nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me datën 02.10.2018, ka parashtruar ankesë, me numër protokolli 5663/2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 03.10.2018, me numër protokolli 5698/2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme, ndërsa me datën 05.10.2018 me numër protokolli 5770/2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme, me shkresat e bashkangjitura.

***Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova***: Ankesën A nr. 619/2018 , e datës 02.10.2018, me numër protokolli 5663/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 24.08.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; E-maili zyrtar i datës 14.09.2018; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 03.10.2018; Akt emërim i ankuesit i datës 19.10.2012; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit te emërimit te ankuesit Nr.096/2014, i datës 28.02.2014; Vendim i datës 13.09.2016, me numër Nr.377/2016; Vendim i datës 24.07.2018, me numër Nr.675/2018; Përgjigje në ankesë e datës 05.10.2018, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, respektivisht, Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme , që ti ndërmarrë të gjitha veprimet, për të vendosur lidhur me shqyrtimin e ankesës të datës 24.08.2018, të parashtruar nga ankuesi Arben Qollaku.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, lidhur me parashtrimin e ankesës se ankuesit të datës 24.08.2018, ka qenë i obliguar të veprojë në pajtim me nenin 86 paragrafin 1 dhe nenin 131, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton

se: *„Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative", „Ankesa kundër një akti administrativ do të shqyrtohet, në radhë të parë nga organi kompetent publik"* mirëpo i njëjti komision edhe përkundër këtij obligimi ligjor nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se organet e punësimit janë të obliguara të themelojnë Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil për të shqyrtuar çdo ankesë që paraqitet nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil, ashtu siç parashihet me nenin 82 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se *„Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës".*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme që në pajtim me nenin 86 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të bëjë shqyrtimin e ankesës së ankuesit Arben Qollaku dhe të nxjerr vendim meritor ne pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, .

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

***Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës***
***Lënda Nr. A. Nr. 619/2018.***

***Malsore GASHI-BAJRAKTARI***
***Kryetare e Kolegjit***

***Ardita Perçuku-Shyti***
***Procesmbajtës***

***Vendimi i dërgohet:***

- *Ankuesit; Arben Qollaku;*
- *Sekretarit te Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme;*
- *Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, të Ministrisë së Punëve të Jashtme;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*